

**RAPORT MBI SESIONIN INFORMUES PËR QYTETARËT –
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT BASHKIAK &
PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJE**



Organizuar nga: Këshilli Bashkiak Përmet në bashkëpunim me Kryetaret e Bashkisë

Data e zhvillimit: 23 korrik 2025

Vendi: "Salla e Këshillit Bashkiak"

Numri i pjesëmarrësve: Rreth 60 qytetarë

Koha e zhvillimit: 10:00–11:00

Transmetimi Live: Në Facebook dhe në kanalën zyrtar të YouTube të Këshillit Bashkiak

Njoftimi për publikun: Ftesat u ndanë dhe njoftimi në rrjetet sociale u bë një javë përpara

datës së sesionit, si edhe dy ditë përpara dhe ditën e eventit ku ishin të ftuar të gjithë qytetarët të mërrn in pjesë fizikisht në sesionin informues ose të na ndiqnin në transmetimin live.

Qëllimi i Aktivitetit

Ky sesion informues u organizua me qëllim rritjen e transparencës dhe përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse vendore, përmes prezantimit të strukturës, rolit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak si organ përfaqësues dhe ligjvënës në nivel vendor, si edhe si një mundësi për të gjithë qytetarët që të jepnin sugjerimet e tyre për një bashkëpunim më të mirë me këshillin bashkiak dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje.

Agjenda e Sesionit

1. **Hapja e aktivitetit dhe përshëndetja hyrëse** – nga Sekretari i Këshillit Bashkiak, i cili theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si një instrument i dialogut dhe transparencës institucionale.
2. **Prezantimi kryesor mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak** – i mbajtur nga **Kryetaria e Këshillit Bashkiak, e cila:**
 - Sqaroi rolin e këshillit si organ përfaqësues dhe përgjegjës për miratimin e buxhetit, vendimmarrjen për gëshje të rëndësishme të jetës komunitare, dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së ekzekutivit.
 - Ilustroi ndarjen e kompetencave ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë.
 - Sqaroi mënyrën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, rolit të komisioneve të përhershme, transparencës së vendimeve dhe angazhimit për pjesëmarrje qytetare.
3. **Diskutime dhe pyetje nga të pranishmit** – Qytetarët shprehën interes dhe bënë pyetje mbi:
 - Mundësitë për të paraqitur kërkesa apo propozime nga qytetarët;
 - Përdorimi i fondeve publike;
 - Raportimi i drejtpërdrejtë dhe transparencë në mbledhje

Pjesëmarrësit në Aktivitet

- Kryetaria e Këshillit Bashkiak
- Nënkryetaret e Bashkisë Përmet
- Sekretari i Këshillit Bashkiak
- Këshilltarë Bashkiakë të pranishëm
- Kryetarët e fshatrave në Bashkinë Përmet



- Qytetarë nga komuniteti vendor – me një listë prezence të dokumentuar

Elementë të Dokumentuar

- Lista e plotë e pjesëmarrësve është arkivuar në format fizik dhe digjital.

Transmetimi i sesionit është regjistruar dhe arkivuar në platformat e Keshillit Bashkia (Facebook dhe YouTube) https://www.youtube.com/watch?v=dK_YH6jK57c

- Fotografite dhe materialet vizuale janë përgatitur për qëllime komunikimi publik dhe arkivim

Rezultatet dhe Vlerësimi i Aktivitetit

- Aktiviteti u vlerësua pozitivisht nga të pranishmit si një hap i rëndësishëm për përfshirjen qytetare.
- Pyetjet e shumta dhe diskutimet treguan një nivel të lartë interesi për proceset e vendimmarrjes.
- Transmetimi live ka mundësuar ndjekjen e aktivitetit edhe nga qytetarë që nuk ishin fizikisht të pranishëm, duke rritur transparencën.

Vazhdimësia

Bazuar në interesin dhe rëndësinë e këtij sesioni, Keshilli Bashkia ka vendosur ta shndërtojë këtë sesion informues në një traditë vjetore, si pjesë e angazhimit për:

- Rritjen e transparencës institucionale
- Forcimin e pjesëmarrjes qytetare
- Edukimin demokratik të komunitetit

Sugjerime për Sesionet e Ardhshme

1. Zgjerimi i fushatës së informimit për të rritur më shumë akoma pjesëmarrjen – përfshirë njoftime në media lokale dhe kontaktimi i drejtpërdrejtë me organizata vendore dhe persona publik që kanë ndjekës të shumtë në rrjetet e tyre sociale për të bërë në to njoftimin për sesionin informues.
2. Përdorimi i pyetësorëve për feedback në fund të sesionit për të matur ndikimin dhe përmirësuar formatin.

Përgatitur nga:

Sekretari i Keshillit Bashkia Permet

Data: 23 korrik 2025

Institucioni: Keshilli Bashkia Permet

